

BAZA PËR KONKLUIZONE

“PËR

DISA NDRYSHIME NË SKK 2 PARAQITJA E PASQYRAVE FINANCIARE”

	BAZA E KONKLUIZONEVE
	OBJEKTIVI DHE BAZAT E PËRGATITJES
BK1	Paragrafi 26 ndryshon për të reflektuar Art 5.1 të Direktivës e cila kërkon që njësi të paraqesë në shënimet shpjeguese një informacion lidhur me regjistrin tregtar ku mbahen të dhënat e njësisë ekonomike dhe numrin e identifikimit të kësaj njësie në regjistrin tregtar.
	PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
	Rregulla të përgjithshme
BK2	Paragrafi 29 ndryshon për të reflektuar Art 6.1 të Direktivës ku thuhet shprehimisht se në pasqyrën e pozicionit financiar tepricat e çeljes për çdo periudhë raportuese duhet të korespondojnë me tepricat e mbylljes së periudhës raportuese paraardhëse. Në praktikën kontabël kjo është një kërkesë e gjithë zbatueshme edhe pse e pashkruar në ndonjë nga dokumente që rregullojnë kontabilitetin dhe parimet e paraqitjes së informacionit financiar.
BK3	Paragrafi 31A , shtohet i ri për të reflektuar kërkesën e Art 12.1 të Direktivës ku kërkohet që njësi ekonomike të japë informacion tek shënimet shpjeguese për ato aktive/detyrime që lidhen me më shumë se një zë të caktuar të pasqyrës së pozicionit financiar.
BK4	Paragrafi 31B , shtohet i ri për të reflektuar kërkesën e Art 12.4 të Direktivës ku kërkohet që njësi ekonomike të paraqesë në zërin “Toka dhe ndërtesa” edhe të drejta të tjera që ka mbi këto aktive.
BK5	Paragrafi 31C , shtohet i ri për të reflektuar kërkesën e Art 12.10 të Direktivës ku kërkohet që njësi ekonomike të paraqesë në aktiv të pasqyrës së pozicionit financiar diferencën për raste kur shuma për të shlyer huanë ndodh të jetë më e madhe se huaja dhe ta pakësojë atë diferencë me një shumë të arsyeshme çdo vit deri sa të bëhet shlyerja e plotë e huasë.
	Kompensimi i aktiveve dhe detyrimeve (njohja në shumën neto)
BK6	Paragrafët 46 dhe 60 ndryshohen me të njëjtin tekst për të reflektuar Art 6.2 të Direktivës i cili kërkon që të jepen në shënimet shpjeguese shumat bruto të vlerave të aktiveve/detyrimeve apo të ardhurave/shpenzimeve që janë paraqitur në pasqyra për vlerën e tyre neto pas kompensimit.
	PASQYRA E PERFORMANCËS
	Rregulla të përgjithshme
	Kërkesat e zbatueshme
BK7	Paragrafi 52 ndryshohet për të reflektuar Art 16.1 të Direktivës ku kërkohet që njësi ekonomike të paraqesë në pasqyra apo në shënimet shpjeguese ato zëra të të ardhurave/shpenzimeve që janë të jashtëzakonshëm për nga natyra apo madhësia. Paragrafi 52, ashtu si është publikuar në SKK 2 të vitit 2008 dhe në variantin e përmirësuar 2015, parashikon që njësi ekonomike të mos paraqesë zëra të jashtëzakonshëm, në linjë me sa kërkohet tek SNRF-të. Por për qëllime të transpozimit të Direktivës në këtë paragraf bëhet një ndryshim për të reflektuar të dyja setet e raportimit financiar, duke kërkuar në paragrafin 52 të ndryshuar që zërat e jashtëzakonshëm të mos paraqiten në pasqyra por të jepen vetëm tek shënimet shpjeguese;

BK8	<p>Paragrafi 52A shtohet i ri për të reflektuar Art 18.1 të Direktivës ku kërkohet që njësitë ekonomike me interes publik, subjekt i zbatimit të këtij standardi, për shumën e të ardhurave të shfrytëzimit paraqitur në pasqyrën e performancës, të japin informacion në shënimet shpjeguese lidhur me ndarjen e saj sipas kategorive të aktivitetit dhe tregjeve gjeografike, për sa kohë këto kategori dhe tregje ndryshojnë ndjeshëm nga njëri tjetri, referuar mënyrës si janë organizuar shitjet e produkteve dhe ofrimi i shërbimeve; Gjithashtu ku paragraf parashikon rastin kur kjo kërkesë paraqitje mund të mos respektohet nga njësitë ekonomike, kërkesë që buron nga Art 18.2 i Direktivës.</p>
DATA DHE RREGULLAT E ZBATIMIT TË STANDARDEVE	
BK9	<p>Paragrafi 95 përcakton datën efektive të ndryshimeve që pëson SKK 2 i përmirësuar. Ndryshimet kanë datë efektive 1 janar 2019 dhe zbatohen në mënyrë prospektive.</p>